

V E N D I M
Nr. 440, datë 9.9.1999

PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË NDËRTIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Policia e Ndërtimit funksionon në varësi të Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit. Struktura e Policisë së Ndërtimit përbëhet nga drejtoria e saj, me qendër në Tiranë, dhe 12 degë, të organizuara në shkallë prefekturë, nga të cilat katër degë të kategorisë së parë dhe tetë të kategorisë së dytë, sipas strukturës organike, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Policisë së Ndërtimit të jetë 150 veta. Efektet e rritjes me 50 punonjës shtesë në Policinë e Ndërtimit të përballohen nga shkurtimet në sektorin e shërbimeve në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

3. Niveli i pagave për punonjësit e Drejtorisë së Policisë së Ndërtimit në Tiranë dhe prefektura të njehsohet me nivelin e pagave të punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, sipas tabelës nr. 2, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Punonjësit e Policisë së Ndërtimit të marrin shtesë page, për natyrë të veçantë pune, deri në masën 30 për qind mbi pagën bazë dhe një shtesë mbi pagë, për vështirësi shërbimi, në masën 30 për qind, në bazë të përcaktimit që do të bëjë Ministri i Punëve Publike dhe Transportit.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga rritja e numrit të punonjësve të Policisë së Ndërtimit në masën prej 13 (trembëdhjetë) milionë lekësh në fondin e pagave dhe 4 (katër) milionë lekë në fondin e sigurimeve shoqërore, të përballohen me fondet buxhetore të dhëna për vitin 1999 për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit.

6. Vendimi nr. 28, datë 17.1.1994 “Për organizimin dhe strukturën e Policisë së Ndërtimit”, vendimi nr. 468, datë 3.10.1994 “Për disa shtesa në numrin e punonjësve të Policisë së Ndërtimit”, si dhe vendimi nr. 284, datë 7.7.1997 “Për strukturën dhe organizimin e Policisë së Ndërtimit” shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko